



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.682/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Rustem Thaqi anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Perparim Shala kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gllogoc, të paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, verifikim i rezultateve, për Zgjedhjet lokale të 17.10.2021. në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.682/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Perparim Shala kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për verifikim të rezultateve në vendvotimet 0310E/01R, 0310E/02R, 0310E/03D, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar ankesën Anr.682/2021, nga Perparim Shala kandidate për Kuvend Komunal nga rradhët e Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Gllogoc, në të cilën thekson se në qendrat e votimit 0310E/01R, 0310E/02R, 0310E/03D, dyshohet se ka pasur keqpërdorim të votave nga personat përgjegjës, i njejtë thekson se për ta

vërtetuar këtë mund të kontaktohen personat te cilet me kan votuar, ku kam bashkangjitur edhe deklaratën me shkrim nga Ardison Hoxha, me tutje thekson se nuk i janë numruar 30 (tridhjetë) vota.

Si deshmi ankesës i ka bashkangjitur deklaratën me shkrim nga Ardison Hoxha.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet me nr. 0310E/01R, 0310E/02R, 0310E/03D, në Komunën e Glllogocit, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Perparim Shala nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 682/2021 më datën 20.10.2021

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

